



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:184673
Datë: 12.01.2024
Numri i dokumentit: 05182846

PA1.nr.1508/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Pergjithshem, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Mehmet Ndrecaj, anëtarë, me praktikantin gjyqesor Arben Arifi, si procesmbajtës në lëndën penale ndaj të akuzuarve S.B., nga fshati..., K. Malishevë, per shkak te vepres penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së dhe te akuzuarit L.B., nga fshati..., K. Malishevë, per shkak te veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, per te vendosur sipas ankeses se përfaqësuesit me autorizim të palës së dëmtuar A.D., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtine – Dega ne Glllogovc, P.nr.246/23 të datës 12.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 04 Janar 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e përfaqësuesit me autorizim të palës së dëmtuar A.D., ndersa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtine – Dega ne Glllogovc, P.nr.246/23 të datës 12.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtine – Dega ne Glllogovc, P.nr.246/23 të datës 12.09.2023, i akuzuari S.B., eshte shpallur fajtores per shkak te vepres penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, per te cilen i eshte shqiptuar denimi me gjobë ne shumë prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro dhe i akuzuari L.B., eshte shpallur fajtor per shkak te veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, per te cilën i eshte shqiptuar dënimi me gjobe ne shume prej 350 (treqind e pesëdhjetë) euro e te cilat gjoba janë obliguar qe t'i paguajnë ne afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se ketij aktgjykimi, ne te kundërtën dënimet e shqiptuara me gjobe do të iu zëvendësohen ne dënim me burgim ku per çdo 20 euro te gjobës do të iu llogaritet 1 dite burgim.

Nëse te akuzuarit nuk e paguajnë gjobën gjithashtu me pëlqimin e te akuzuarve ne vend te zëvendësimit ne dënim me burgim mund të iu zëvendësohet edhe me urdhër ne dobi te përgjithshme ku per çdo 8 ore te punës ne dobi te përgjithshme do të iu llogariten me 20 euro.

I dëmtuari A.D., per realizimin e kërkesës pasurore juridike eshte udhëzuar ne kontest te rregullt civil.

Të akuzuarit janë obliguar qe t'i paguajne shpenzimet e procedures penale qe dalin sipas llogarise perfundimtare te gjykates, ne emer te paushallit gjyqesor secili veç e veç shumen prej nga 30 (tridhjetë) euro, si dhe per fondin e kompensimin e viktimave te krimit secili veç e veç shumen prej nga 20 (njezet) euro, e te gjitha keto ne afat prej 30 ditesh pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankese ka ushtruar :

Përfaqësuesi me autorizim i palës se dëmtuar A.D., av.Hasan Haxhaj nga Drenasi, per shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar qe aktgjykimi i ankimuar i gjykates se shkalles se pare te ndryshohet, dhe te akuzuarve per veprat penale të kryera të iu shqiptohen dënime më të larta me gjobë, e me te cilat dënime do te arrihej qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 te KPRK-se.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u skjaruar përkitazi me ankesen e përfaqësuesit me autorizim te palës se dëmtuar, me shkresën e vet PPA.II.nr. 1542/2023 të datës 29.11.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesen përfaqësuesit me autorizim te palës se dëmtuar ta aprovoje si te bazuar, ndersa aktgjykimi i ankimuar i Gjykates se shkalles se pare te ndryshohet dhe te akuzuarve te iu shqiptohen denime me te larta me gjobë se sa denimet e shqiptuara nga ana e gjykates se shkalles se pare.

Gjykata e Apelit mbajti seancen e kolegjit ne pajtim me nenin 390 paragrafi 1 te KPPRK-se, per te cilen nuk i ftoi palet ngase ne rastin konkret kemi te bejme me denime me gjobë edhe pretendimet ankimore jane vetem lidhur me sanksionin penal andaj prezenca e paleve nuk eshte e obliguar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore te përfaqësuesit me autorizim te palës se dëmtuar A.D., dhe gjeti se:

- Ankesa nuk eshte e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës të njejtin e shqyrtoi në këtë aspekt sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

As gjendja faktike nuk ka qenë objekt shqyrtimi ngase të akuzuarit gjatë shqyrtimit fillestar të datës 12.09.2023 në bazë të nenit 242 të KPRK-së kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat janë akuzuar, i cili pranim eshte bërë në mënyrë vullnetare nga te akuzuarit. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet që përmban aktakuza dhe provat që gjenden në

shkresat e lëndës. Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike del që në rastin konkret drejtë është aplikuar edhe ligji penal.

Sa i perket vendimit mbi sanksionin penal përfaqësuesi me autorizim i palës se dëmtuar, me ankesë pretendon se Gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit të dënimeve me gjobë ndaj të akuzuarve, i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë për veprat penale të kryera, pendimin, keqardhjen, se më parë nuk ka qenë e gjykuar mirepo nuk i ka vlerësuar rrethanat renduese si faktin se të akuzuarit kanë sulmuar dhe i kanë shkaktuar lëndime trupore palës se dëmtuar në vendin e tij të punës dhe në prezencë të kolegëve me të cilët punon pala e dëmtuar, pastaj se i akuzuari L.B. është recidivist, e sikur keto rrethana të ishin vlerësuar në mënyrë të duhur është dashur që të akuzuarve të iu shqiptohen denime më të larta me gjobë e të cilat do të ishin në proporcion me shkallen e rrezikshmerisë, mënyrën e kryerjes së kryerjes së veprës penale si dhe pasojën e shkaktuar dhe se me denimin e shqiptuar nga ana e gjykates së shkalles se pare nuk mund të arrihet qëllimi i denimit i parapare me nenin 38 të KPRK-së, andaj ka propozuar që ankesa e përfaqësuesit me autorizim të palës se dëmtuar të aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore lidhur me sanksionin penal të përfaqësuesit me autorizim të palës se dëmtuar për shqiptimin e dënimeve më të larta me gjobë dhe pas vlerësimit të njejtës, dhe duke i patur parasysh rrethanat e cekura më lartë dhe rrethanat e rastit konkret, Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata e shkalles se pare drejte dhe në mënyrë të plote i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, andaj konstaton se denimet e shqiptuara me gjobë ndaj të akuzuarve nga ana e gjykates së shkallës së parë janë në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale të kryera, andaj e refuzoi si të pabazuar ankesën e përfaqësuesit me autorizim të palës se dëmtuar për shqiptimin e dënimeve më të larta me gjobë, duke e vërtetuar aktgjykimin e Gjykates së shkalles se pare, e me bindje se me denimet e shqiptuara nga ana e Gjykates së shkalles se pare, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tyre, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1508/23 më 04.01.2024

Procesmbajtësi
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit
Skender Çoçaj

Mehmet Ndrecaj
